Ne te gjithe gjatesine e rruges do te ndertoht sistemi i rrjetit shperndares te ndricimit rrugor, i cili përfshin vendosjen shtyllave me lartësi 7m, krahët për cdo shtyllë për të realizuar ndricimin e plotë të rrugës, tubat plastik fleksibël me dy shtresa $\varnothing=63\text{mm}$ dhe 75mm për kalimin e kabllit të furnizimit me energji elektrike dhe tub celiku $\varnothing=110\text{mm}$ për intersektimin e trupit te rruges.

Ndricimi rrugor do të realizohet me llampa ndricimi me fuqi 250 ë eficence energjitike (referuhu projektit).

Ndriçuesit do jenë me gradë të lartë rezistence dhe me reflektor alumini me luçidim të lartë i paoksidueshëm. Energjia i rrjetit të ndriçimit do të merret ne kabinën egzistuese te zones. (Keto pika lidhjeje mund te ndryshohen nese nuk do aprovohen nga KESH).

Në cdo kabine do të instalohen panelet e ndricimit rrugor te cilet do ushqehen me ure të veçante nga transformatori. Në cdo kabinë eshte parashikuar dhe vendosja e matësve të energjisë.

9 TE DHENA PER MJEDISIN EKZISTUES

9.1 Pershkrimi i mbuleses bimore te siperfaqes bimore ku propozohet te ndertoht projekti dhe fotografite perkatese

Pamje nga degëzimi i rrugës “Rexhep Tarja”, dhe degezimi i saj, Rruga”Kleanthi Koci”, e marrë në studim në hyrje me rrugën kryesore.







Figura 8 Foto te gjendjes ekzistues

9.2 Klima

Në aspektin klimatik zona në studim hyn në nënzonën klimatike fushore qendrore perëndimore ku mbizotëron klima mesdhetare fushore me dimër të butë dhe verë të nxehtë. Temperatura mesatare vjetore varion nga 15°C deri në 16°C. Temperatura mesatare e Janarit varion nga 6°C deri 7°C. Temperatura maksimale absolute 41.5°C e regjistruar më 18.07.1973, temperature minimale absolute -10.4°C, është regjistruar më 15.01.1968. Reshjet mesatare shumëvjeçare janë 1270mm. Reshjet më të mëdha gjatë periudhës së vrojtimeve meteorologjike nga viti 1951 deri në vitin 2005 për qytetin e Tiranës kanë qenë 1770mm më 1937, dhe më të voglat 773mm në vitin 1975. Shpejtësia e erës në drejtime të ndryshme është nga 1.5 deri 3.0 m/s

Parametrat klimatik të Tiranës

	Emërtimi	Vendmatja Tiranë
1	Temperatura mesatare vjetore, °C	15.2
2	Temperatura mesatare më e lartë në verë, °C	29.9
3	Temperatura më e lartë absolute, °C	42.2
4	Temperatura mesatare më e ulët në dimër, °C	6.7
5	Temperatura më e ulët absolute, °C	-10.4
6	Reshjet mesatare vjetore, mm	1270
7	Reshjet maksimale vjetore, mm	1770
8	Reshjet minimale vjetore, mm	773
9	Avullimi mesatar (E.T.P); (E.V), mm	880; 600
10	Drejtimi mbizotërues i erës vjetore	N; Ë (14.6%)

11	Mbizotërimi i drejtimit të erës në verë	N: Ë (2- -5%)
12	Mbizotërimi i drejtimit të erës në dimër	S.E. (17- -5%)
13	Shpejtësia mesatare e erës, m/sek	1.8
14	Presioni bazë i erës, kg/m ²	0.281
15	Thellësia maksimale e borës, cm	15
16	Thellësia maksimale e ngrirjes së tokës në cm	10
17	Lagështia relative mesatare vjetore, %	70
18	Lagështia relative mesatare në verë, %	63
19	Lagështia relative mesatare në dimër, %	73
20	Numri mesatar i ditëve me reshje ≥ 0.1 mm	129
21	Numri mesatar i ditëve me reshje ≥ 1 mm	100
22	Numri mesatar i ditëve me reshje ≥ 5mm	64
23	Numri mesatar i ditëve me reshje ≥ 10mm	45
24	Zgjatja faktike e diellzimit ne orë, vjetore	2530
25	Magnituda maksimale e pritshme	60-70

9.3 Temperatura e Ajrit

Temperatura e ajrit është një nga elementet kryesor klimatik që shërben për të karakterizuar klimën e një vendi apo një rajoni. Me regjimin mesatar, me ecurinë e saj vjetore e ditore si dhe me vlerat ekstreme, ndikon në strukturat ndërtimore.

Paraprakisht duhet vënë në dukje se gjithë Ultësira Bregdetare (ku ndodhet zona në studim) gjendet nën ndikimin e fuqishëm të detit Adriatik.

Një nga parametrat më të rëndësishëm të temperaturës së ajrit është temperatura mesatare e tij. Për të studiuar shpërndarjen e këtij elementi në zonën në studim si dhe shpërndarjen e tij gjatë vitit, në tabelën Nr. 2 jepen temperaturat mesatare të vendmatjes meteorologjike Tiranë.

Tabela Nr. 2 Temperatura mesatare mujore dhe vjetore e ajrit

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Me s
Tiranë	6.9	7.9	9.9	13.3	17.7	21.6	23.8	23.8	20.6	16.1	11.8	8.2	15.1

Të dhënat e mësipërme paraqiten në formë grafike në figurën Nr. 2




Fig. 2 Shpërndarja brendavjetore e temperaturave mesatare të ajrit

Përsa i përket luhatjes brenda vitit të temperaturës së ajrit duhet thënë se kemi të bëjmë me një regjim tipik mesdhetar ku temperatura minimale vrojtohet në muajin Janar, 6.9°C, ndërsa temperatura maksimale vrojtohet në muajt Korrik dhe Gusht 23.8°C.

Një parametër tjetër i rëndësishëm i temperaturës së ajrit është edhe temperatura ekstreme e tij (minimale dhe maksimale). Në tabelat Nr. 3 dhe 4 jepen temperaturat minimale dhe maksimale absolute të temperaturës së ajrit për vendmatjen meteorologjike Tiranë.

Për temperaturat minimale është bërë një analizë më e detajuar për vetë kushtet që kërkohen kur bëhen një projekt për rrugën automobilistike dhe sistemimin e lumit të Tiranës.

Kështu janë llogaritur ditët me temperaturë negative (të ashtuquajtura ditë të ftoha) për vendmatjen meteorologjike Tiranë.

Për objektin që po studiojmë në zonën tonë, rëndësi paraqesin gjithashtu edhe numri i ditëve me temperature nën -10°C, që quhen ditë të akullta. Në zonën në të cilën shtrihet objekti në studim, temperaturat nën -10°C janë tepër të rralla dhe në tabelën Nr 5 janë dhënë ditët me temperature nën -5°C.

Tabela Nr. 3 Temperatura maksimale absolute

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Tiranë	21.3	27.7	29.6	31.7	35.8	37.9	41.5	40.3	37.0	31.4	26.9	22.5	41.5

Tabela Nr. 4 Temperatura minimale absolute

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
										10	11	12	

Tiranë	- 10. 4	- 7. 6	- 7. 0	0. 0	1. 8	5. 6	9. 4	10. 0	3. 8	- 1. 3	- 6. 1	- 6. 9	-10.4
--------	---------------	--------------	--------------	---------	---------	---------	---------	----------	---------	--------------	--------------	--------------	-------

Tabela Nr. 5 Numri i ditëve me temperature $\leq 0^{\circ}\text{C}$

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Tiranë	10. 3	5. 5	3. 8	0. 0	0. 0	0. 0	0. 0	0. 0	0. 0	0. 3	3. 4	8. 6	32.2

Tabela Nr. 6 Numri i ditëve me temperaturë $\leq -5^{\circ}\text{C}$

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Tiranë	1. 1	0. 4	0. 0	0. 0	0. 0	0. 0	0. 0	0. 0	0. 0	0. 0	0. 0	0. 4	1.9

Nga të dhënat e mësipërme vihet re se ditë të ftohta ndodhin gjatë periudhës së ftohtë të vitit (Nëntor-Mars) ku më të shquarit janë muajt Dhjetor dhe Janar, ndërsa ditët me temperaturë nën -5°C janë shumë të rralla dhe vetëm një ditë është në muajin Janar.

Në përfundim, përsa i përket temperaturave të ajrit duhet thënë se zona në studim karakterizohet nga një klimë e butë mesdhetare.

9.4 Mjegulla

Mjegulla është ngjarje atmosferike që vështirëson transportin rrugor, detar dhe ajror sidomos kur ka intensitet të madh.

Paraprakisht, duhet thënë se mjegulla si fenomen atmosferik është dukuri e rrallë në Shqipëri. Për pasojë edhe zona në studim preket shumë pak nga kjo dukuri.

Për të analizuar mjegullën do të ndalemi në dy aspekte, në numrin e ditëve me mjegull dhe kohëzgjatjen e saj në orë. Të dhënat mbi mjegullën jepen në tabelën Nr. 7

Tabela Nr. 7 Numri mesatar i ditëve me mjegull

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Mes
Tiranë	2. 5	2. 0	0. 7	0. 2	0. 7	0. 1	0. 0	0. 1	0. 4	0. 5	1. 5	1. 6	10. 5

Nga tabela Nr. 7 rezulton se mesatarja vjetore më e madhe është 10.5 ditë me mjegull në Tiranë-kjo është edhe më e madhja në të gjithë Ultësirën Bregdetare-ku në Shkodër është 6.1 ditë dhe në Vlorë 1.5 ditë në vit.

Në përgjithësi në muajt e stinës së verës në vendmatjen meteorologjike të vendit tonë, mjegulla është një dukuri e rrallë.

Nga analizat e materialit të ngjarjeve atmosferike të elementit mjegull për të cilët jepet numri i ditëve me mjegull, u llogarit edhe koha e zgjatjes së mjegullës. Rezulton se në të gjithë zonën në studim mjegulla zhvillohet pas mesit të natës, rreth orës 2 ose 3 dhe vazhdon deri në orën 9-10 të mëngjesit. Por nuk përjashtohen rastet kur mjegulla zhvillohet në orët e mbrëmjes. Si rregull, në muajt e periudhës së ngrohtë të vitit, mjegulla zhvillohet rrallë dhe në qoftë se ka raste që zhvillohet nuk zgjat shumë kohë, p.sh. në Tiranë kohëzgjatje mesatare e mjegullës është 2 orë e 24 minuta. Kohëzgjatja maksimale pa ndërprerje e mjegullës në Tiranë është realizuar më 29 dhe 30 Janar 1968 për 11 orë e 43 minuta.

9.5 Reshjet atmosferike

Reshjet atmosferike janë nga elementët më të rëndësishëm klimatik që përcaktojnë veçoritë klimatike të një zone.

Në rastin e projektimit të një rruge apo aq më tepër blloku banimi veçoritë e reshjeve atmosferike kanë një rol të rëndësishëm sepse kanë të bëjnë me projektimin e sistemit të drenazhimit që lidhet direkt me mirëmbajtjen e rrugës dhe nga ana tjetër lidhet edhe me kushtet e transportit të mjeteve lëvizëse.

Faktorët që ndikojnë në karakteristikat e reshjeve atmosferike janë në pozicionin gjeografik, afërsia me detin dhe orografia. Objekti që po studiojmë shtrihet në pjesën perëndimore të vendit, në Ulëtirën bregdetare pranë detit Adriatik me një relief të ulët fushor dhe vargmale që e rrethojnë nga lindja dhe e mbrojnë nga erërat e forta lindore kontinentale. Në tabelën e mëposhtme jepen të dhënat mbi reshjet mujore dhe vjetore.

Tabela Nr. 8 Reshjet mujore dhe vjetore

dmajt	vend	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	etore
ranë	89	35	26	13	02	92	63	38	45	84	11	62	41	210

Konkretisht në zonën në studim, sasia e reshjeve vjetore është rreth 1200mm. Sasia më e madhe e reshjeve ku janë regjistruar 1770mm dhe më e vogla 770mm në vit. Në krahasim me vlerën mesatare të territorit Shqiptar (140mm), kjo zonë është më e ulët në sasinë e reshjeve atmosferike.

Siç tregohet në figurën Nr. 3 shpërndarja e reshjeve gjatë vitit ka një formë “U” që është tipike e një regjimi Mesdhetar të reshjeve. Sasia më e madhe e reshjeve pritet gjatë periudhës së ftohtë të vitit dhe muajt më të lagët janë Nëntor-Dhjetor (162 dhe 141mm përkatësisht). Muaji më i thatë është Korriku (38mm).




Fig. 3 Shpërndarja brendavjetore e reshjeve atmosferike, Tirane

Për objektin që do të përcaktojmë, përveç reshjeve mujore e vjetore, rëndësi paraqesin edhe shpeshtësia e shfaqjes së reshjeve të vogla si: 0.1 mm, 1.0 mm, 5 mm dhe 10 mm. Për këtë qëllim janë llogaritur për gjithë periudhën me të dhëna për vendmatjen meteorologjike Tiranë numri i ditëve me reshje ≥ 0.1 mm, ≥ 1.0 mm, ≥ 5 mm dhe ≥ 10 mm.

Tabela Nr. 9 Karakteristikat kryesore të reshjeve

Vendmatja	Numri i ditëve			
	Reshje ≥ 0.1 mm	Reshje ≥ 1 mm	Reshje ≥ 5 mm	Reshje ≥ 10 mm
Tiranë	129	100	64	45

Reshjet intensive në sasi të mëdha për intervale të ndryshme kohëzgjatje dhe sidomos për kohëzgjatjet e mëdha, vrojtohen situata të caktuara sinoptike dhe sidomos ku ciklonet dhe frontet atmosferike janë stacionar. Ato gjithashtu janë të lidhura me llojin e reve dhe të ndikimeve lokale.

Duke pasur parasysh sasinë maksimale për 24 orë të reshjeve dhe intensitetin për intervale të ndryshme kohe në periudha të ndryshme kthimi (return periods) zona në studim karakterizohet për intensitete të lartë të reshjeve. Në vendmatjen meteorologjike Tiranë brenda 24 orëve kanë rënë 237.4 mm.

Si ndryshim i ndryshueshmërisë së madhe në kohë dhe hapësirë të reshjeve maksimale 24 orëshe, e domosdoshme është edhe se çfarë sasi reshjesh janë të mundshme gjatë 24 orëve në zonën në studim dhe sa shpesh përsëriten ato.

Për këtë qëllim u llogaritën reshjet maksimale për periudha përsëritje të ndryshme. Në tabelën Nr. 10 jepen reshjet maksimale mujore dhe vjetore

Tabela Nr. 10 Maksimumi 24 orësh i reshjeve

Nr	Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Me larta
1	Tiranë	85	89	65	77	123	103	59	79	98	237	194	130	237

Si në rastin e reshjeve 24 orëshe për qëllime praktike në tabelën Nr. 11 jepen reshjet 24 orëshe me siguri të ndryshme; gjithashtu në tabelën 12 jepen lartësitë maksimale të reshjeve për kohëzgjatje 10`, 20`, 30`, 1^h, 2^h, 6^h, dhe 12^h me periudhë përsëritje një herë në 100 vjet, 50 vjet, 10 vjet dhe 2 vjet.

Tabela Nr. 11 Reshjet më të mëdha me siguri të ndryshme

Nr	Vendmatja	Siguri të ndryshme					
		1	2	5	10	20	50
1	Tiranë	180	162	141	124	106	78

Tabela Nr. 12 Lartësitë maksimale të reshjeve për kohëzgjatje dhe periudhë përsëritje të ndryshme

Vendmatja	100%							20%							5%						
	10`	20`	30`	1 ^h	2 ^h	6 ^h	12 ^h	10`	20`	30`	1 ^h	2 ^h	6 ^h	12 ^h	10`	20`	30`	1 ^h	2 ^h	6 ^h	12 ^h
Tiranë	32	38	46	66	92	122	17	29	45	58	81	114	144	25	30	35	47	69	97	123	

10%							20%							50%						
10`	20`	30`	1 ^h	2 ^h	6 ^h	12 ^h	10`	20`	30`	1 ^h	2 ^h	6 ^h	12 ^h	10`	20`	30`	1 ^h	2 ^h	6 ^h	12 ^h
22	27	32	42	60	84	106	19	24	28	35	51	71	88	14	19	22	28	38	51	62

9.6 Bora

Në vendin tonë, në periudhën e ftohtë të vitit, një sasi e konsiderueshme e reshjeve vjen prej borës. Kjo veçori është më e theksuar në zonën malore ku bora është një dukuri e zakonshme.

Në zonën në studim bora vrojtohet rrallë she mund të konsiderohet si dukuri e jashtëzakonshme. Numri më i madh i ditëve me borë në zonën në studim është rreth 3 ditë në vit.

Nga të dhënat e tabelës Nr. 13 rezulton se muaji Janar ka numrin më të madh të ditëve me borë, duke u ndjekur nga Shkurti dhe Dhjetori.

Tabela Nr. 13 Numri mesatar i ditëve me borë.

N r	Vendma tja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Shu ma vjet.
1	Tiranë	1.3	0.9	0.4	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.3	1.3

Në zonën në studim, për shkak të ndikimit zbutës të detit nuk ka kushte të përshtatshme për krijimin e shtresës së borës. Ajo krijohet rrallë, por edhe kur krijohet, nuk mund të qëndron gjatë. Bora krijon shtresë dhe mund të qëndrojë gjatë vetëm në dimra të jashtëzakonshëm të shoqëruar me temperatura negative të ulëta të vazhdueshme siç kanë qenë rastet e vitit 1949 ku bora arriti lartësinë 40cm dhe qëndroi disa ditë, Dhjetori i 1957 dhe Janari 1985. Mund të përmendim edhe vitet 1954-1955, 1960 dhe 1965. Lartësia mesatare maksimale e shtresës së borës në Tiranë arrin 8cm.

9.7 Lagështia e ajrit

Si një tregues i rëndësishëm i lagështirës së ajrit shërben lagështia relative e ajrit shërben lagështia relative e ajrit e cila ka një ndikim të drejtpërdrejtë në aktivitetin njerëzor. Në ecurinë vjetore të këtij treguesi vërehen ndryshime që janë kushtëzuara nga qarkullimi stinor dhe relievi. Të dhënat e tabelës Nr. 14 tregojnë se vlerat më të larta të lagështirës relative të ajrit vrojtohen në gjysmën e ftohtë të vitit, gjë që shpjegohet me veprimtarinë ciklonare që vrojtohet në zonën e marrë në studim gjatë kësaj periudhe të vitit.

Vlerat më të larta i takojnë muajve Nëntor, Dhjetor dhe Janar. Ndërkaq vlerat më të ulëta ë lagështirës relative vrojtohen në muajin Korrik dhe Gusht, pikërisht kur mbi rajonet e Mesdheut vërehet një qëndrueshmëria anti-ciklonare e theksuar. Ecuria ditore e lagështirës relative është e kundërt me atë të temperaturës së ajrit. Në orët e para të mëngjesit realizohen vlerat më të larta kurse në orët e mesditës (para ose pas mesditës) vlerat më të ulëta.

Në zonën në studim mbizotëron forma qarkullimit perëndimor i cili duke u çvendosur nga perëndimi në lindje, sjell me vete masa ajrore të pasura me lagështirë dhe relativisht të ngrohta. Gjithashtu rritja e sasisë së reshjeve nga fundi i vjeshtës dhe fillimi i pranverës bën që lagështia relative gjatë vitit të qëndrojë në vlera pothuajse të përafërta.

Tabela Nr. 14 Ecuria e lagështirës relative gjatë vitit

N r	Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Mes. vjetore	Amplit
1	Tiranë	73	71	71	72	71	66	61	64	70	72	76	76	70	15

Për këtë arsye, zona në studim ka vlerë relativisht të lartë të lagështirës është relative dhe me ndryshime jo shumë të ndjeshme nga muaji në muaj më tjetrin. Amplituda vjetore midis vlerës më të lartë 76% dhe asaj më të ulët 61% është 15%. Lagështia mesatare vjetore është 70%.

9.8 Era

Gjatë projektimit të rrugëve automobilistike dhe autostradave, një aspekt tjetër i rëndësishëm është edhe vlerësimi i karakteristikave të erërave në zonën në studim. Në parametrat kryesor të erës përfshihen edhe të dhënat për drejtimin e saj (shpeshtësia sipas drejtimeve të ndryshme) si dhe shpejtësia e saj sipas drejtimeve të ndryshme tabela 15 dhe figura 4.

Tabela Nr. 15 Rastisja mesatare shumëvjeçare e drejtimit të erës dhe shpejtësia mesatare sipas drejtimeve.

N r	Vendmatja	Q	N		N.E.		E		S.E		S		SË		Ë		N.Ë		
			r	s	r	s	r	s	r	s	r	s	r	s	r	s	r	s	
1	Tiranë	44	35	27	28	20	31	15	28	45	24	74	27	32	29	15	21	15	29

r-rastisje; sh-shpejtësia në m/sek




Figura 9 Trendafilii i erës për Tiranën

Vendmatja meteorologjike Tiranë karakterizohet nga një vlerë 44% e gjithë vitit me qetësi (nuk ka erë 44% e periudhës vjetore). Shpejtësia mesatare varion nga 2.9 m/s në 1.5 m/s ndërsa ajo maksimale arrin në raste

të veçanta atmosferike (tufane) deri në 40 m/s. Rastisjen më të madhe e ka drejtimi i erës Jug-lindje me rastisje në përqindje 15.8, dhe jug-perëndimi me 15.1%.

Në periudhën e dimrit rastisja (në %) e drejtimit të erës është për 20.9% në pranverë për drejtimin veriperëndimor është 15.4%, në verë për drejtimin VP. është 20.1% dhe në vjeshtë për drejtimin JL është 14.6%.

Shpejtësia e erës në territorin e zonës në studim ashti si në të gjithë vendin tonë, është në vartësi të periudhës së vitit. Vlerat më të mëdha të tyre vrojtohen në stinën e dimrit kur veprimtaria ciklonare është e theksuar.

Tabela Nr. 16 Shpejtësitë mesatare të erës m/sek.

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Mes. vjetore
Tiranë	1.6	1.8	1.7	1.5	1.5	1.3	1.6	1.5	1.3	1.3	1.3	1.4	1.5

Në vartësi të lëvizjeve të sistemeve barike dhe orografisë së zonës që studiojmë, era pëson ndryshime të rëndësishme. Të dhënat e deritanishme për shpejtësinë e erës përcaktojnë dhe karakteristikat e veçanta lidhur me forcën e saj. Në tabelën e mëposhtme jepen të dhënat e rastisjes së erës në përqindje.

Tabela Nr. 17 Rastisja e shpejtësisë së erës në %

Nr	Vendmatja	Shpejtësi 0-1 m/s	Shpejtësi 2-5 m/s	Shpejtësi 6-10 m/s	Shpejtësi 11-15 m/s	Shpejtësi ≥15 m/s
1	Tiranë	59.7	36.1	4.0	0.2	0.1

Në këtë tabelë shihet se shpejtësitë nga (0-1m/sek) mbizotëron në të gjithë zonën në studim, mbizotërojnë dhe shpejtësitë (2-5m/sek) dhe rrallë (6-10m/sek). Shpejtësitë (11-15m/sek) janë të rralla.

Gjatë ditës era arrin shpejtësinë maksimale sidomos në orët e mesditës. Kjo lidhet me lëvizjet vertikale të ajrit sidomos gjatë stinës së verës. Shpejtësitë maksimale arrijnë 20 deri 30m/sek.

Si erëra lokale në zonën në studim janë evidentuar brizat detare (puhitë)

9.9 Stuhitë

Stuhitë që për vendin tonë janë të shumta dhe ndodhin në të gjithë stinët e vitit, shpesh shoqërohen me breshër. Më shumë ditë me breshër ka në muajt e dimrit dhe gjysmën e vjeshtës dhe në gjysmën e parë të pranverës. Numri më i madh i ditëve me breshër vrojtohet në rrethin e Tiranës dhe Kamzës. Tirana gjatë viti ka 8 ditë me breshëri. Në Tiranë më 14 Maj 1963 gjatë 40 minuta breshëri, është formuar një shtresë disa cm e gjatë.

Tabela Nr. 18 Numri mesatar i ditëve me breshër.

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Tiranë	1.1	1.3	0.9	1.3	0.6	0.3	0.1	0.1	0.2	0.3	0.9	1.0	8

Si rregull, zgjatja e breshrit është 3 deri 5 minuta. Në zonën në studim, breshëri vrojtohet në çdo kohë të vitit por më shumë në periudhën e ftohtë të vitit. Gjatë muajit Janar pothuajse vrojtohet mesatarisht një ditë me breshëri, Ne periudhën e ngrohtë të vitit numri i ditëve me breshër është i pakët.

Stuhitë në zonën në studim mund të ndodhin në çdo muaj, kjo tregon karakterin mesdhetar që ka klima e zonës tonë. Në thellësi të territorit të Gadishullit Ballkanik gjatë periudhës së ftohtë të vitit (dimrit) stuhitë pothuajse nuk ndodhin fare, kjo shpjegohet me karakterin kontinental të klimës më atë rajon.

Tabela Nr. 19 Numri mesatar i ditëve me stuhi

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Tiranë	1.8	1.9	1.5	2.6	4.1	2.7	2.8	2.1	2.2	2.8	3.4	2.4	30.3

Nga analiza e tabelës Nr. 20 rezulton se me më shumë ditë në zonën në studim (Tiranë) ka 30.3 ditë në vit. Numri më i madh i ditëve me stuhi është në Maj me 4.1 ditë.

Shkaku kryesor që maksimumi i ditëve me stuhi vrojtohet në muajin Maj duhet kërkuar në qarkullimin e masave ajrore dhe në rastin e cikloneve.

Muaji Maj përfshihet në periudhën kur qarkullimi dimëror i atmosferës zëvendësohet me qarkullimin veror të atmosferës me ardhjen e masave ajrore nga deti për në thellësi të territorit të vendit tonë.

9.10 Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyres

Rajoni nëpër të cilin do të bëhet rikonstrukcioni i rruges nuk ndodhet në zonë të mbrojtur.

Per sa i peket zonave te mbrojtura Tirana eshte e pasur me monumente natyre te cilat jane te listuara me poshte:

Nr.	Monumenti Natyror
1	Bokërimat e Mustafa Koçajt
2	Shpella e Shutresë
3	Shpella e Zezë (Pëllumbasit)
4	Shpella e Valit

5	Tarraca detare e Dajtit
6	Karsti i Malit me Gropa
7	Gryka e Skoranës
8	Gryka e Murdarit
9	Shkalla e Tujanit
10	Bokërimat e Mnerit
11	Rrapi i Priskës
12	Rrapi i Kranës – Dajt
13	Rrapi i Ndroqit
14	Arra e Babë Myslymit

9.11 Ujerat Siperfaqësore

9.12 Gjeologjia inxhinierike

Sinklinali i Tiranës paraqet një zonë të ulët, si një basen anësor, i mbushur me depozita melase të erës seravalian-tortonian. Ultësira e Tiranës mbaron në zonën tektonike të Krujës. Pjesa e kufirit perëndimor përputhet me pjesën ballore të zonës tektonike të Krujës. Sinklinali i Tiranës paraqet një njësi të ulët e mbivendosur në pjesën perëndimore të zonës tektonike të Krujës. Ai paraqet një njësi strukturale e formuar në periudhën më të re gjeologjike, gjatë Seravalian- Pliocenit. Ky sinklinal karakterizohet nga një krah i gjerë lindor, me një rënie të butë perëndimore që konfirmon periudhën sizmike, e cila paraqet një tendencë të re lëvizjeje.

Zona në vlerësim ndertohet nga depozitime të trajtuara:

- Depozitime të kuaternarit
- Depozitime Molasike të Neogjenit

Depozitimet e kuaternarit: Depozitimet detare përfaqësohen nga zhavorre kokërr vogël deri në zhurë, rera, surera, suargjila, argjila dhe shtresa trofike. Janë depozitime pak deri në mesatarisht të konsoliduara, takohen në të gjithë zonën ku do të ndertohet objekti. Depozitimet e Neogjenit: në këto depozitime takohen depozitimet e Neogjenit që përbehen nga argjilite dhe alevrolite me ngjyrë gri me cimentim të dobët deri në mesatar, pjesa e sipërme e këtyre depozitimeve është e perajruar. Fenomenet më të dukshme gjeologjike dhe gjeodinamike që vërehen në këto zone janë: Fenomeni i perajrimit, i cili është i dukshëm të formacionet rrenjesore që përbehen nga argjile dhe alevrolite, këto shkëmbinj janë depozitime të reja dhe me cimentim të dobët argjilor.

Rajoni i Tiranës dhe Durrësit ndertohet nga depozitimet terrigjene të sistemit mio-pliocenik dhe kuaternarit, të cilat sipas përberjes litologjike klasifikohen në dy grupe të mëdha:

- Formacioni molasik dhe
- Depozitimet kuaternare

9.13 Sizmiciteti

Zona bën pjesë në territorin me intensitet lëkundjeje 7 ballë të shkallës Rihter sipas hartës së rajonizimit sizmik të Shqipërisë.

Rajoni në studim bën pjesë në brezin strukturor perëndimor të UPM, ku pergjithesisht pranohen marrëdhënie suksesive të depozitimeve. Karakteristike janë ndertimi i komplikuar tektonik, sedimentet kanë trashësi të fuqishme si dhe prania e strukturave antiklinale dhe sinklinale me shtrirje veri-veriperëndim, të formuara gjatë fazës tektonike pliocen-kuaternar.

Rajoni i Tiranës nga ana tektonike ndahet në tre elemente strukturale:

Në sinklinalin e Erzenit të poshtëm, me harkun lindor monoklinalin e Pezës, pjesa e veriut antiklinali i Kavajës dhe sinklinali i Durrësit. Lugina e Erzenit të poshtëm, përfaqëson në vetevetë pjesën e një depresioni të thellë e të mbushur me depozitime kuaternare sipërfaqësore nën të cilat shtrihen depozitimet Pliocenike. Lugina ka formë ovale. Boshti i saj ka shtrirje veriperëndim-juglindje. Nga jugu lugina e Erzenit të poshtëm kufizohet nga antiklinali i Kavajës që është një strukturë jo e madhe me bosht veriperëndimor. Në bërthamë ka depozitime Burdiglianit, ndërsa në krah dhe në periklinale depozitime të Tortonianit deri në Pliocen. Gjatë sharnierit kjo strukturë komplikohet nga një prishje tektonike, e cila në pjesën jugore kalon në kahun perëndimor të saj. Krahu lindor i antiklinalit të Durrësit, në të cilin bën pjesë edhe zona e vendosjes së objektit, ndertohet nga argjila të miocenit të sipërm, nga pakoja e fuqishme e ndërshtrezimeve të argjilave dhe ranoreve të moshës Pliocenike. Sipas të dhënave të puseve kahu lindor i kësaj strukture shkeputet tektonikisht.

9.14 Neotektonika

Rajoni i Tiranës, sikurse e gjithë Ultesira pranë adriatike është kapur nga një levizje shtypese paspliocenike dhe është formuar nga rrudha larërreshqitese, mbihypje dhe kundrahypje, si dhe shtytje. Levizjet shpypese vazhdojnë dhe sot. Në baze të intensitetit dhe kronologjisë së levizjeve vertikale në Ultesirën anësore Praneadriatike vëcohen këto elemente sipërfaqësore:

- Ngritje mesatare të fuqishme nga plioceni.
- Zhytje mesatare deri të fuqishme në pliocen dhe ngritje e dobët në kuaternar.

Rajoni i Tiranës është kapur nga zhytja e fuqishme në pliocen dhe kuaternar. Struktura e rrudhosur e Ultesirës Praneadriatike i nënshtrohet dy fazave shtypese:

- Njera me e dobët në kufirin Miocen-Pliocen.
- Tjetra me e fuqishme në Pleistocen të poshtëm.

Deformimet shtypese vazhdojnë deri në ditë tona. Rajoni i Durrësit ndertohet nga disa linja antiklinale relativisht të ngushta (nga studimet gjeofizike të

kryera edhe ne det) dhe sinklinale te gjera, lineare Mio-Pliocenike me shtrirje veriperndim deri afer verior. Nga perendimi ne lindje evidentohen keto struktura mio-pliocenike:

- Linja antiklinale Lushnje – Kavaje qe mbyllet ne gjirin e Lalzit.
- Sinklinali i Erzenit te poshtem, i cili vazhdon ne drejtim te veriut, deri ne detin Adriatik.
- Monoklinali i Pezes
- Sinklinali i Tiranës ndiqet pjeserisht ne det deri tek terthorja e Lezhes.

Depozitimet kuaternare detare dhe aluviale, si rregull kane nje trashesi deri 150-200m dhe shtrihen horizontalisht mbi malosen e rrudhosur miocenike-pliocenike.

Nga interpretimet gjeologjike te bera per shkeputje gjatesore te medha dhe rrudhat antiklinale MioPliocenike qe i shoqerojne ato ne Ultesiren Praneadriatike rezulton se mbihipjet dhe kundrahipjet jane ende aktive ne ditet tona, kete e deshmojne termetet e fuqishme te gjeneruara prej tyre.

9.15 Komuniteti lokal dhe social-ekonomia

Bashkia Tirane, e përbërë nga 14 njësi administrative, është një pjesë e rëndësishme e qarkut Tirane. Ky qarku ka një popullsi prej 800 197 banorë dhe përbën 6% të popullsisë së vendit, e ndarë në 5 Bashki.

Popullsia e Bashkisë Tirane (duke përfshirë të gjitha njësitë administrative të saj), me një numër prej 757 361 banorë (INSTAT, Census 2011) Të dhënat e Regjistrimit të gjendjes civile, flasin për një popullsi më të lartë në krahasim me të dhënat e Censurit 2011. Kjo për arsye se lëvizjet brenda vendit, pas vitit '89 nuk shoqëroheshin gjithmonë me procedurat e regjistrimit në Regjistrin e gjendjes civile të zonës ku vendoseshin. Gjithashtu, edhe dukuria e emigracionit ndikon në mosparaqitjen e gjendjes reale të popullsisë. Në çdo rast, nga këto të dhëna vihet re një fluks hyrës dhe dalës duke sjell për pasojë uljen të ndjeshme të popullsisë në zonat periferike.

Informacion per pranine e burimeve ujore ne siperfaqen e zene nga projekti dhe ne afersi te tij

Ne zonen e zbatimit te ketij projekti nuk ka burime ujore te rendesishme te identifikuar ato ndodhen ne distance. Te burimet ujore te kesaj zone jane mund te permendim Lumi e Tiranës. Burimi ujqor me i afert i zones eshte Lumi i Tiranës.

Sistemi Ujqor i Bashkisë së Tirane përbëhet prej dy rrjedhjesh kryesore ujore te cilat jane Lumi i Tiranës dhe Lumi i Lanës.

10 INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TË MUNDSHME, NEGATIVE, NË MJEDIS, TË PROJEKTIT, PËRFSHIRË NDIKIMET NE BIODIVERSITET, UJË, TOKË DHE AJËR.

Ky raport hartohet mbi bazen e parimit te mbrojtjes se mjedisit dhe ne funksion te institucioneve vendim-marrese per licensimin ose jo te aktiviteteve te ndryshme te cilat mund te kene ndikim ne mjedis. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme veprimtarite te cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet baze te mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- ❖ Parimet e mbrojtjes se mjedisit
- ❖ Parimi i zhvillimit te qendrueshem
- ❖ Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- ❖ Parimi i ruajtjes se burimeve natyrore
- ❖ Parimi i zevendesimit dhe/ose kompensimit
- ❖ Parimi i qasjes se integruar
- ❖ Parimi i pergjegjesise se ndersjelle dhe bashkepunimit
- ❖ Parimi "Ndotsi paguan"
- ❖ Parimi i se drejtes per informim dhe i pjesemarrjes se publikut
- ❖ Parimi i nxitjes se veprimtarive per mbrojtjen e mjedisi

Mbrojtja e mjedisit nenkupton mbrojtjen e integruar te perberesve te mjedisit nga ndotja, si veçmas, ashtu dhe ne kombinim, duke pasur parasysh nderveprimet ndermjet tyre dhe qysh ne fazen e planifikimit te zhvillimit te nje territori te caktuar.

Mbrojtja e perbersve te mjedisit klasifikohet ne:

- ❖ Mbrojtja e ajrit
- ❖ Mbrojtja e ujerave
- ❖ Mbrojtja e tokes
- ❖ Mbrojtja e natyres
- ❖ Ndryshimet klimatike

Ky projekt do te kryhet ne rruge ekzistuese, ne te cilen nuk ka bimesi te larte, nuk ka park natyror, nuk ka demtime te bimesise se zones.

Bazuar në llojin e projektit të propozuar ndikimet më thelbësore mund të analizohen sipas dy fazave të veprimtarisë:

- ❖ Në fazën e ndërtimit të rruges
- ❖ Në fazën e funksionimit te rruges

Rendesi ka te kuptohet natyra e këtyre proceseve dhe forma e shfaqjes së tyre, direkte apo indirekte, në mënyrë që të përcaktohet qartë lloji i ndikimeve.

Duke analizuar edhe shtrirjen në tokë të këtyre ndikimeve, ato klasifikohen në:

- ❖ Ndikime të kthyeshme në mjedis
- ❖ Ndikime ta pakthyeshme në mjedis

Të dy llojet e ndikimeve mund të minimizohen në terma relative ku qëllimi kryesor është mbajtja e tyre brenda sipërfaqes së objektit të kërkuar dhe krijimi i kushteve natyrore për të siguruar riaktivizimin e proceseve të natyrës dhe rigjenerim të ekosistemit.

Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të projektit u ndoqën hapat e mëposhtëm:

- ❖ Njohja me projektin dhe fazat e zbatimit të tij.
- ❖ Njohja me natyrën e operacioneve të nevojshme në mjedis.
- ❖ Njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore të zonës dhe sipërfaqes.
- ❖ Konsultimi me dokumenta ligjorë e administrativë dhe raporte të VNM-së për veprimtari të njëjta.
- ❖ Vlerësimi i rëndësisë së ndikimeve të identifikuar.

Ndikimet kryesore në mjedis nga ndërtimi dhe funksionimi i kësaj rruge konsistojnë në vijat e përgjithshme si më poshtë:

- ❖ Emetimet në ajër dhe zhurmat
- ❖ Shkarkimet në ujë
- ❖ Ndikimi në tokë
- ❖ Ndikimi në flore/faunë
- ❖ Mbetjet e prodhuara
- ❖ Ndikime social-ekonomike
- ❖ Ndikim në cilësinë e jetës në qendrat e banuara
- ❖ Ndikim në rritjen e trafikut rrugor
- ❖ Ndikim në peizazhin e zonës
- ❖ Ndikim në ndryshimet klimatike

Ndikimet mjedisore e sociale të projektit janë konsideruar në dy fazat e tij; atë të ndërtimit dhe të funksionimit. Nëse faza e ndërtimit ka një qartësi kohezgjatjeje, ajo e operimit dhe/apo e mbylljes janë krejtësisht të varura nga mirëmbajtja e objekteve

Ndikimet social-ekonomike të projektit

Për vetë natyrën e territorit ku do të kryhen punimet për ndërtimin e objektit, duhet theksuar faktin që ky projekt nuk prek në mënyrë negative pronat private apo aktivitete ekonomike, vlera sociale etj. Gjithashtu, nuk pritet të shkaktojë demtime të vlerave ekonomike apo aktiviteteve të biznesit dhe karakteristikave sociale. mund të sjellin pengesë në aktivitetet e përditshme

sociale dhe pengesa socio ekonomike të zonës. Implementimi i projektit kërkon specialistë dhe punëtorë. Numri i punëtorëve që do të punojnë për ndertimin do të jetë një burim punësimi për punëtorë të kualifikuar dhe jo të kualifikuar gjatë gjithë periudhës. Kjo do të sjellë një impakt pozitiv tek popullsia vendase të cilët do të përfitojnë në dy mënyra nga ndërtimi:

- Krijimin e punesimit direkt
- Fitimi indirekte për bizneset vendase

Ndikimet ne mjediset specifike social kulturore

Ndër ndikimet negative socio-kulturore ndonëse klasifikohen ne ato gjatë fazes së ndertimit dhe ato gjate fazes se veprimit, janë konsideruar vetem të parat. Gjate fazës operuese nuk pritet të ketë ndikime mbi vlerat arkeologjike, historike apo kulturore etj. Aktiviteti që kryhet nuk prek zonat turistike, zona të mbrojtura, zona arkeologjike, arkitekitektonike.

Ndikimet e përgjithshme ndërtimore dhe orientime per masat zbutëse

Territori i punimeve gjate fazës së ndërtimit do të kufizohet në minimumin e mundshëm të sipërfaqeve të objektit që do të ndertohej. Per te gjitha rastet do te merren masa te menjehershme sipas planit te menaxhimit te paraqitura ne kapitullin e meposhtem.

Ndikimet ne burimet ujore

Ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugeve ka si impakti potencial ndotjen e ujrave sipërfaqesore si rezultat i germimeve, mbetjet, baltat e gjeneruar nga perdorimi i makinerive te renda ose shkarkimi aksidental i lubrifikateve, solventeve, bojrave dhe vajrave.

Ndikimet e mundshme gjatë fazës së ndertimit

Sistemi i ujrave sipërfaqesore pritet të pësojë ndikim gjatë fazës së ndërtimit si rezultat i punimeve me germime, nga mbeturinat, balta e gjeneruar nga përdorimi i makinerive të rënda ose nga derdhja aksidentale e lubrifikantëve, vajrave, naftës etj. Persa i perket ujarve nentokesore dhe habitateve ujore të zonës janë të pasura por ndodhen larg zonës ku do të punohet dhe ndikimi konsiderohet i ulët.

Ndotjet aksidentale të ujrave sipërfaqesore e nëntokësore, mund të ndiqen nga pasoja në shendet, shkaterrim të habitateve etj. Këto pasoja mund të vinë si rezultat gjermimeve për hapjen e themeleve. Per te parandaluar ndotjet aksidentale, apo evituar pasojat e tyre, vëmendje e veçantë do ti kushtohet respektimit të rregullave teknike dhe aplikimit të eksperiencave me të mira inxhinierike në lidhje me rastet e aksidenteve.

Ndikimet e mundshme gjate fazes së funksionimit te projektit

Nuk pritet të ketë ndikime të konsiderueshme negative gjatë fazes së operimit. Në raste të demtimeve të elementeve funksionale të objektit, si impakti potencial është ndotja e ujrave sipërfaqesore nga mbetjet, baltat e gjeneruar

nga perdorimi i makinerive te renda ose shkartkimi aksidental i lubrifikateve, solventeve, bojrave etj. Nëse nje fenomen i tille ndodh, do të ketë impakt te konsiderueshëm.

Ndikimet negative në tokë dhe mbetjet

Edhe ndikimet negative në tokë janë parashikuar si për fazën e ndërtimit edhe për atë të funksionimit/mirëmbajtjes. Për të parcahtuar ndikimet ne tokë duhet analizuar e gjitha zona në të cilën do te kyhet ndertimi.

Ndikimet e mundshme gjatë fazës së punimeve

Bazuar ne kete tip projekti mbetjet nga ndërtimi jane te konsiderueshme duke marre parasyh se kemi te bejme me rruge egzistuese. Pritet qe ndikimi ne toke te jete mesatar duke marre parasysh punimet qe do te kryhen. Duke u bazuar ne studimet e tokes dhe karakteristikave te saj jane marre parasysh ne fazen e ndertimit te rrugëve Ndikime te tjera mund te jenë dhe sintetike, të vajrave lubrifikante dhe te materialeve te ndertimit, te cilat do te gjenerohen nga punetorët. Ndotja e tokes, gjate ndërtimit mund të ndodhe nga depozitimi i mbetjeve aksidentale nga makineritë.

Në varesi te tipit të ndotjes do të mund te percaktohet nese dëmi është afatshkruter apo afatgjate. Megjithate madhësia e ketij impakti pritet që të jetë mesatare.

Mbetjet

Gjate ndertimit parashikohen të kryhen punime ne tokë me anë të punimeve me gërmime ose nivelime të cilat do të shtrihen gjate gjithë zonës së projektit. Kryesisht do të jene mbetje të cilat do të vinë nga prishjet e jashtme dhe te brendshme te cituara dhe ne kapitullin e mesiperm. Nje pjese e konsiderueshme do te riciklohen për ndërtim. Pjesa tjetër do të grumbullohet dhe do të depozitohet ne venddepozitimin përkatës në bashkëpunim me autoritetin vendor bazuar edhe ne VKM Nr. 575, date 24.06.2015, “Per menaxhimin e mbetjeve inerte” pas miratimit te lejeve perkatese.

Materialet e ketyre lloj mbetjeve janë:

- Beton
- Dhera të germuara (gurë ose baltë)
- Materiali druri
- Materiale plastike

Një pjesë e rëndësishme është dhe transporti i mbetjeve ne vendspozitimet përkatëse. Sipas ligjit të ndërtimit me marrjen e lejes së ndërtimit lidhet një kontrate e licencuar për këtë lloj shërbimi me subjekt të licencuar.

Pas transportit, këto mbetje do të trajtohen në venddepozitimin përkatës në përputhje me kontratën me subjektin.

Ndikimet e mundshme gjatë fazes se shfrytezimit të projektit

Ndikimet negative të mundshme gjatë fazës se shfrytezimit, mbeten ato të natyres aksidentale. Keto ndikime mund të rrezikojnë seriozisht ndotje dhe kontaminim të tokës të cilat mund të vijnë nga erozioni.

Ky projekt ndodhet në një zonë fushore urbane dhe rreziku i erozionit nuk parashikohet të jete prezent.

Ndikimet në ajër

Ndikimet në ajër, sikurse ato në ujëra dhe tokë, janë konsideruar për të dy fazat; atë të ndërtimit dhe operimit. Cilësia e ajrit gjatë fazës së ndërtimit të projektit do të ndikohet tërësisht nga trafiku i dhe nga gjërmimet. Norma Shqiptare i referohet respektivisht normave të emisioneve të ajrit (VKM, numër 435 i datës 12.09.2002) dhe normat për cilësinë e ajrit urban (VKM No. 803 i datës 04.12.2003). Puna ndërtimore mund të shkaktojnë ndotje pjesërisht duke i tejkalluar kufinjve të lejuara për shkak të kamionëve dhe zhvendosjeve të dheut.

Ndikimet negative gjate fazes se ndertimit

Volumi i konsiderueshëm i materialeve të ndërtimit do të transportohet në vendet e punimeve me kamion duke shkaktuar një sasi gazesh djegiese. (CO, NOx, tymi, dhe HC), dhe automjetet ligjërisht duhet t'i respektojnë ato. Rritja e përkohshme e trafikut gjatë fazes së ndërtimit mund të krijojë pasoja të tjera të ndryshme si krijimi i pluhurit dhe emetimeve të shkarkimeve të gazeve mund të ndikojnë në shëndetin e njerëzve me stafit të punëtorëve duke qenë se shkaktojnë probleme respiratore. Ky projekt ndodhet në një zonë qendrore urbane dhe impakti pritet të jete i larte.

Ndikimet negative gjate fazes se operimit/mirembajtjes

Gjatë fazës së operimit ndikimet pritet të jene te pakonsiderueshme pasi shkarkimet nuk do të jenë të pranishme. Megjithate duhen të merren parasysh situatat aksidentale në cilat mund të krijojnë ndikime të cilat parashikohen të jene në nivele të ulta

Ndikimet në zonat e gjelbra specifike dhe biodiversitet

Terreni ku do të sistemohen akset rrugore janë akse pa bimësi . Gjithashtu përreth ndodhen objekte bimore formale dhe pallate të cilat kanë bimësi të larte e cila nuk do të ketë ndikim afatgjatë.

Ndikimet e mundshme gjatë fazës së ndërtimit

Heqja e bimësisë në përgjithësi nuk do të çojë në shkatërrimin e habitateve me vlera të ndryshme si për florën dhe faunën (p.sh. gjitarët, zogjtë, zvarranikët, insektet) që jetojnë në zonën e parashikuar për të kryer punime. Ajo nuk do të ndikojë gjithashtu në migrimin e kafshëve që jetojnë atje dhe krijimin e habitateve të reja për speciet me të tjera preferencë habitati.

Si pasoje e këtyre nderhyrjeve që parashikohen nuk do të kemi degradim të mbulesa bimë duke pakesuar edhe komunitetin faunistik. Ky objekt nuk ndodhet në zonat të konsideruara Monumente Natyre apo Zona të Mbrojtura

Ndikimet e mundshme gjatë operimit te projektit

Projekti nuk do të prodhojë asnjë degradim të rëndësishëm apo shndërrim të zonave të rëndësishme pyjore dhe të habitateve pyjore të rëndësishme. Duke marrë parasysh ndikimet aksidentale që mund të ndodhin në ujë dhe në tokë mund të themi se vetëm në raste të tilla mund të kemi ndikim në florën dhe faunën e zonës ku do të kryhen punime.

Ndikimet ne peisazh

Për këtë projekt peisazhi nuk do të ketë ndikim të madh duke qënë se kemi të bejmë me infrastrukture ekzistuese. Imapakti vizual do të pësoje ndryshime nga një akrtitëkture e vjeter i nje objekti egzistues në një objekt të ri me permiresime ne aspektin vizual.

Duke u bazuar ne punimet e këtij projekti, impakti vizual do te ketë ndryshime te konsiderueshme krahasuar me situaten aktuale do te ketë nje harmoni me peisazhin dhe ndërtime përreth.

Depozitimi i mbetjeve te ngurta në ambientin përreth nuk do të lejohet gjatë fazës së ndertimit, duke shmangur keshtu grumbullimin dhe krijimin e pirgjeve te dheut.

Ndikimet ne zhurma

Levizja e mjeteve të transportit të materialeve, mund të shkaktojë zhurmë gjatë fazës së ndërtimit. Gjithashtu përdorimi i makinerive gjatë punimeve, mund te jetë një burim zhurmash. Niveli i zhurmave në kete projekt mund të rritet përkohësisht.

Zona e këtij projekti është urbane dhe ndjeshmëra ndaj zhurmave është e konsiderueshme. Gjithashtu gjate fazes se operimit zhurmat e emetuara nga punimet e mirembajtjes ose shkarkimeve elektrike duhet te mbahen ne nivele te lejuara.

Karakterizimi i ndikimeve

Më poshtë do të trajtohet karakterizimi i ndikimeve te identifikuara sipas fazave te projektit. Në analizën e ndikimeve janë konsideruar ndikimet pozitive e negative, ato direkte dhe indirekte, në nivele vendore, rajonale e kombëtare apo me gjerë. Ndikimet globale janë te pakonsiderueshme per kete nivel projekti, por sidoqofte janë marre në konsideratë.

Ndikimet pozitive

Ndikimet positive gjate fazës se ndertimit kane origjine dhe natyre krejtesisht lokale. Ne menyre empirike mund te thuhet se shumë punonjes do te mobilizohen per ndertimin e objektit.

Nje tjeter ndikim pozitiv mund te konsiderohet gjenerimi i punes ne entitetet e tjera, aktiviteti i te cilave lidhet direkt me tregetine e materialeve te ndertimit, sherbimet, etj. Ky mund te konsiderohet si nje ndikim i rendesishem me natyre indirekte. Te tjera ndikime pozitive perftohen nga

zbatimi I planit te menaxhimit per evitimin e ndikimeve negative dhe permiresimin/ruajtjen e kushteve te pershtatshme mjedisoro-higjenike.

Efektet pozitive te kesaj faze jane shume me te gjera dhe me efektive nga ato te fazes se ndertimit. Per vete natyren e tij, projekti ndikon ne menyre te rendesishme aspektin ekonomik.

Ndikimet Negative

Duke patur parasysh natyren e projektit, karakterizimi i ndikimeve negative mbetet nje nga pjeset me te rendesishme te VNMse ne fjale. Ndikimet negative potenciale/kumulative jane klasifikuar sipas fazave te zhvillimit te projektit dhe marrin ne konsiderate elementet e meposhtme:

- Burimin e Ndikimit/Rrezikut

Burimet kryesore negative te ndotjes mbeten ato te nxitura nga proceset e ndertimit dhe aksidentet gjate fazave te operimit. Ndotjet nga gjenerimi i mbetjeve, operimi i mjeteve dhe automjeteve, gjeneratore, etj, mbeten disa nga ndotesit kryesore.

- Zonat qe ndikohen nga ndikimet negative per vete natyren e projektit jane te ndryshme.

Ndikimet do te shtrihen kryesisht vetem ne zonen ku do te behet rregullimi i rrugeve. Domethenien e ndikimit (efektet dhe kohezgjatjen) si dhe mundesite per tu zbutur.

ç) Nje pershkrim per shkarkimet e mundshme ne mjedis, te tilla si: ujera te ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe per prodhimin e mbetjeve

Nje pershkrim i shkurter per shkarkimet e mundshme ne mjedis:

1. Shkarkimet ne mjedis nga zbatimi i ketij projekti, ne terma te shkurtuara do te ishte: Shkarkime ne ajer nga aktiviteti ndertimor. Pluhurat fluturues te ndertimit, gazet e mjeteve te ndertimit dhe te transportit.
2. Shkarkime ne ujera nga ujerat e shiut nga kantieri. Shkarkimet e mbetjeve te ngurta, mbetjet urbane nga aktiviteti human.
3. Zhurmat e punimeve ndertimore, nga mjetet e renda, nga transporti.

Emetimet ne ajer

Emetimet ne ajer vijne nga perhapja e pluhurave te materialeve te ndertimit ne sipërfaqen ku kalon njolla e rrugeve. Gjithashtu djegia e lendes djegese, qe shkaktohet nga automjetet qe frekuentojne zonen. Nga punimet ndertuese do te kete perhapje te pluhurave nga qarkullimi i mjeteve.

Keto mjete duhet te plotesojne patjeter kushtet teknike te qarkullimit rrugor, te mos ngarkohen me shume se kapaciteti i projektuar, te mbulohet karrocera me mushama te posacme, si dhe te lahen rregullisht kur dalin nga kantieri apo ne vendin ku do te kryhen punimet per ndertimin e rrugeve.

Vete zhvillimi i ketij aktiviteti eshte ne te mire te komunitetit dhe do tu mundesoj atyre levizje ne kushte optimal nga nje vend ne tjetrin, zona eshte me cilesi ajeri te dhe subjekti zbatues i projektit eshte i detyruar te plotesoj kushtet ligjore te mjedisit per mbrojtjen e cilesise se ajerit.

Shkarkime ne uje

Punimet per ndertimin e rrugeve nuk do te shkaktojne prishje te regjimit te ujerave nentokesore te zones ku dhe do te kryhen punimet dhe ne sistemin e kullimit dhe drenazhimit. Ujerat qe do te shkarkohen nga ujerat e shiut do te jene te se njejtës natyre me ate te kanaleve kulluese te zones, pak me shume te ngarkuara me llumra argjile per shkak te perberjes gjeologjike te zones. Ujerat nuk do te jene te ngarkuar nga emulsione hidrokarbure ose shkarkime te lendeve kimike te ndryshme. Ato nuk do te prishin cilesine e ujerave te rrjedhjave ekzistuese.

Zhurmat dhe vibrimet

Zhurmat jane nje ndikim i pashmangshem mbi mjedisin gjate ndertimit. Zhurma mund te kufizohet duke ndjekur praktikat e mire-administrimit (pajisje/makineri te kalibruara) qe nenkuptojne se punimet do te kryhen vetem gjate orarit te rregullt te turneve te punes. Pajisjet e ndertimit do te plotesojne te gjitha standartet e zbatueshme te Direktives se BE 2000/14/EC, e Majit 2000. Direktiva zbatohet per prodhuesit e pajisjeve qe shkaktojne zhurme. Te gjitha pajisjet duhet te mirembahen ne gjendje te mire pune. Oraret e transportimit te materialeve te ndertimit ne rruget e daljes do te caktohen me kujdes ne menyre qe te menjanohet cdo shqetesim i trafikut lokal.

Ndotja nga zhurmat mund te vije nga perdorimi i makinerive ne ambjentin e punes. Ne projektin tone te marre ne studim, zhurmat do te shkaktohen kryesisht nga puna gjate fazes se ndertimit e mjeteve te renda te punes, te krijuara do te jene ne perputhje me udhezimin e permendur me siper, dhe nuk do ta kaloje kete kufi.

Zhurma do te jene e perkohshme dhe nuk do te kete akumulim te saj nga receptori njeri. Paksa te ekspozuara nga keto zhurma do te jene punonjesit qe do te punojne ne ndertimin e akeseve rrugore ne Njesite Administrative 4+8+12, (ALi Pash Gucia, Degezimet tek Rruga "Ramamzan Gaxherri", Rruge "rexhep tarja" dhe degezimi i saj Rruga "Kleanthi Koci", per te cilen do te kerkohet zbatimi i masave te sigurimit teknik ne pune dhe midis te tjerash dhe perdorimi i kufjeve nese do te jene te nevojshme. Disa burime qe do te shkaktojne zhurma dhe vibrime jane te paraqitura ne menyre te permbledhur si me poshte:

- Si pasoje e punes se mjeteve te ngarkimit dhe te transportit te materialeve apo inerteve, ndikime nga zhurma do te shkaktohen nga mjetet e ndertimit sic mund te jene, vinci, buldozeri, ekskavatore, kamionat qe transportojne materialet e ndertimit etj.
- Te shkaktuar gjate ndertimit te rruges do te ndikojne ne rritje te nivelit te ndotjes akustike, ky ndikim do te jete i perkohshem vetem gjate ndertimit te rruges.
- Te shkaktuar nga prania e punonjesve, bisedat midis tyre kjo sidomos gjate oreve te nates.
- Te shkaktuara gjate kalimit te mjeteve te ndertimit te tonazhit te rende, te cilat do te shkaktojne edhe vibrime ne mjedisin aty prane.

Gjate ndertimit do te ndikohet vetem ne jeten e punonjesve te ndertimit si dhe ne mjedisin e banuar aty prane sheshit te ndertimit, por ndikimi do te jete ne nivele te ulta. Zhurma e krijuar nuk do te jete e ndryshme nga zhurma e pergjithshme e krujar nga punimet e ndertimeve civile. Zhurma pritet te jete e moderuar por e perkohshme pasi kontraktuesit aplikojne teknologji me te fundit per kontrollin e uljeve te vibrimeve dhe zhurmave ne menyre te konsiderueshme pa rritje te shpenzimeve operative. Matjet shkencore kane treguar nje ulje prej te pakten 35-40 % te nivelit te impaktit te vibrimeve.

Mbetjet e prodhuara

Mbetje te ngurta qe prodhohen nga ndertimi dhe rikonstruksioni i plote i rrjetit rrugor ne Njesite Administrative 4+8+12, (ALi Pash Gucia, Degezimet tek Rruga "Ramamzan Gaxherri", Rruge "rexhep tarja" dhe degezimi i saj Rruga "Kleanthi Koci"), ne kete zone jane mbetjet e ngurta urbane si plastike, qelqi, materiale letre, metale, mbetje organike (paleta druri), materiale inerte te prodhuara nga punimet ndertuese, si dhe dheu e mbetjet inerte qe do te largohen nga vendi i ndertimit. Materialet te cilat jane te riperdorshme, mund t`ju jepen individeve te interesuar per punime ndertimi ne zonat periferike ose rehabilitim te lulishteve ose mbushje te tokave aty ku ka nevojte, pjesa e mbetjeve te pa perdorshme duhet te grumbullohen ne vendin e caktuar nga Njesia e Qeverisjes Vendore (NJ.Q.V) pas zbardhjes se Lejes se Zhvillimit nga autoritetet pergjegjese.

Keto mbetje duhet te menaxhohen ne bashkepunim me Njesine e Qeverisjes Vendore dhe firmen pastruese te territorit dhe ne perputhje me Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte". Grumbullimi i mbetjeve duhet te jete i diferencuar qe ne vendburim. Mbetjet inerte, do te menaxhohen ne bashkepunim me Bashkine Tirane dhe do te depozitohen ne vendin e caktuar per to. Nje pjese e ketyre mbetjeve do te sistemohen ne sheshin e ndertimit pas perfundimit te punimeve. Do te perdoret per mbushje te aneve te themeleve, per sistemimin e sheshit dhe siperfaqet e gjelberta.

Mbetjet e ngurta nga punimet e ndertimit do te jene kryesisht ato inerte te cakullit dhe shtreses se humusit dhe shtresa bimore dhe e tokes e cila do te pastrohet per sheshin e ndertimit.

Depozitimi i mbetjeve inerte të bëhet ne venddepozitim në baze te udhezimeve te Bashkise Tirane dhe ne perputhje me VKM Nr.575, date 24.06.2015 “Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte”. Transporti i mbetjeve inerte të bëhet me mjete teknologjike të pajisur me licensë të tipit III.2.B në bazë të ligjit Nr. 10463, date 22.09.2011, “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”dhe të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të VKM nr.229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”. Gjate kryerjes se punimeve nuk parashikohet te kemi mbetje te rrezikshme, por edhe nqs ka kontraktori duhet te marre te gjithë masat per magazinimin e asgjесimin e tyre mbeshtetur ne VKM nr 371 date 11.06.2014.

Shumica e sasise nga germimet do te perdoret ne punimet mbushese.

Operatoret duhet te jene te paisur me License III.2.B sipas shtojces nr.1 te ligjit nr 10448 date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit” ose ne shesh depozitimet e perkoshme te percaktuara nga Bashkia Tirane ne perputhje me VKM 229 date 23.04.2014” Per menyren e transferimit te mbetjeve jo te rezikshme”, në dokumentacionin e lëshimit të lejes për projektin e ndërtimit, riparimit, restaurimit apo shembjes, përcaktojnë se personi fizik ose juridik, të cilit i është dhënë leja për realizimin e projektit, duhet të provojë me dokumentacionin e nevojshëm përmbushjen e kërkesave të këtij vendimi brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të projektit të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objektit, i cili krijon mbetje inerte.

Sipas VKM Nr.99 date 18.02.2015 Per miratimin e katalogut shqiptar te klasifikimit te mbetjeve te cilat parashikohen te krijohen jane :

20 Mbetje urbane (Mbetjet shtepiake dhe tregtare, mbetje industriale e institucionale te ngjashme) perfshire fraksionet e mbledhura vecmas

20 01 fraksionet e ndara

20 01 01 leter karton

20 01 02 qelq

20 01 08 mbetje te biodegradueshme

20 01 39 plastike

20 02 mbetjet e kopshteve dhe parqeve

20 02 01 mbetje te biodegradueshme

17 09 04 materiale inerte te prodhuara nga punimet si dhe mbetje që perfshihen ne kategorine e KODIT 17 O5 Dhera (duke perfshire dhera te germuar nga toka te kontaminuara, gure dhe balta te tjera) dhe nenkategorine e tij:

Kodi 17 05 04: Dhera dhe gure, te tjera nga ato te permendura ne 17 05 03;

Kodi 17 05 08: Çakell,te tjera nga ato te permendura ne 17 05 07;

Kodi 17 09 04: Mbetje te perziera nga ndertimi dhe te prishjeve;

Per cdo ndikim sado te vogel, subjekti duhet te zbatoje me rigorozitet kushtet e kesaj zone, duke marre ne konsiderate dhe parimin “ndotesi paguan”.

d) Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve te identifikuara

Punimet ndertimore, mund te zgjasin per nje periudhe 3 mujore. Kjo eshte koha normale qe duhet per te perfunduar se ndertuari kete segment rrugor ne kushte normale. Kjo eshte e vlefshme ne kushte teknike, juridike e klime normale, por ne rast se do te hasen veshtiresi gjate punimeve mund te kete edhe shtyrje te afatit. Si rrjedhoje edhe ndikimet e fazes ndertimore do te zgjasin per aq kohe sa zgjasin punimet per ndertimin e rrugeve ne Njesite Administrative 4+8+12, (ALi Pash Gucia, Degezimet tek Rruga “Ramamzan Gaxherri”, Rruge “rexhep tarja” dhe degezimi i saj Rruga “Kleanthi Koci”, Persa i perket ndikimeve gjate fazes se funksionimit ato do te jene prezente per aq kohe sa do te perdoret edhe projekti. Ndikimi ne peisazh do te jete i perkohshem.

dh) Te dhena per shtrirjen e mundshme hapsinore te ndikimit negative ne mjedis, qe nenkupton distancën fizike nga vendodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara qe perfshihen ne te.

Ndikimi ne mjedisin e zones do te kete efektet e tij ne nje distance jo shume te gjere, me dhjetra ose qindra metra, pra ne nje distance jo me te larget se 200-300 m. Ky ndikim do te jete i perkohshem dhe nuk eshte me veti akumuluese ne mjedis. Nuk shkarkohen elemente te demshem per mjedisin, si ne ate ujqor, per ajrin, token dhe per biodiversitetin. Ndikimi ne peisazh do te jete i perkohshem per fazen e ndertimit dhe i perhershem nga ndertimi dhe rikonstruksini i plote i akseve rrugore ne Njesite Administrative 4+8+12, (ALi Pash Gucia, Degezimet tek Rruga “Ramamzan Gaxherri”, Rruge “rexhep tarja” dhe degezimi i saj Rruga “Kleanthi Koci”).

Ndikimi ne mjedisin e zones do te kete efektet e tij ne nje distance jo shume te gjere, me dhjetra ose qindra metra, pra ne nje distance jo me te larget se 200-300 m. Ky ndikim do te jete i perkohshem dhe nuk eshte me veti akumuluese ne mjedis. Nuk shkarkohen elemente te demshem per mjedisin, si ne ate ujqor, per ajrin, token dhe per biodiversitetin. Ndikimi ne peisazh do te jete i perkohshem per fazen e ndertimit dhe i perhershem nga ndertimi dhe rikonstruksini i plote i bllokut te banimit ne akset ne Njesite Administrative 4+8+12, (ALi Pash Gucia, Degezimet tek Rruga “Ramamzan Gaxherri”, Rruge “Rexhep Tarja” dhe degezimi i saj Rruga “Kleanthi Koci”).

Nga analiza e bere e te gjithë faktoreve me ndikim ne mjedis, rezulton se nga aktiviteti i ndertimit te rrugeve ne Njesite Administrative 4+8+12, (ALi Pash Gucia, Degezimet tek Rruga “Ramamzan Gaxherri”, Rruge “Rexhep Tarja” dhe degezimi i saj Rruga “Kleanthi Koci”, nuk do kene shtrirje te mundeshme hapsinore, por do te jene te kufizuara brenda njolles te rruges ekzistuese, pra brenda zones qe zhvillohet projekti.

e) Mundesine e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit te mjedisit te ndikuar te siperfaqes ne gjendjen e meparshme, si dhe kostot financiare te peraferta per rehabilitim.

Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis u orientua nga rëndësia e aktivitetit, vendi ku ai ndodhet, pasuritë natyrore dhe humane të zonës si dhe vlerat e veçanta të tyre në identifikimin e ndikimeve negative dhe pozitive, marrja e masave zbutëse duke patur parasysh edhe ruajtjen e interesave ekonomike të investitorit dhe masat orientuese pas mbylljes së projektit.

Reduktimi i ndikimeve negative është ndërthurur edhe me ndikime të rëndësishme pozitive sidomos në kompensime.

Siperfaqja e lire e vendit te shnderrohet ne nje mjedis te gjelbert, te paster dhe te sigurt ndaj erozionit.

Subjekti investitor, duhet qe pas perfundimit te ndertimit te rrugeve dhe infrastruktures perkatese, te kryeje rehabilitimin e plote te siperfaqeve te lira, pra rindertimi i segmentit rrugor gjate fazes se ndertimit te projektit ne fjale dhe per siperfaqet e gjelberta. Per kete te konsultohen me specialistet perkatese.

Mundesia e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe kthimi i mjedisit ne gjendjen e meparshme. Pas perfundimit te punimeve ndertimore, do te behet pastrimi dhe largimi i mbetjeve inerte qe mund te kene ngelur, gjelberimi qe eshte pjese e projektit, por nuk mund te pretendojme rikthim ne gjendjen e meparshme te vendit ku do te kryhen punimet per ndertimin e rrugeve Njesite Administrative 4+8+12, (ALi Pash Gucia, Degezimet tek Rruga “Ramamzan Gaxherri”, Rruge “Rexhep Tarja” dhe degezimi i saj Rruga “Kleanthi Koci”).

Subjekti investitor, ne kete Bashkia Tirane, duhet qe pas perfundimit te ndertimit te bllokut te rrugeve dhe infrastruktures perkatese, te kryeje rehabilitimin e plote te siperfaqeve te lira, pra rindertimi i segmentit rrugor gjate fazes se ndertimit te projektit ne fjale dhe per siperfaqet e gjelberta. Per kete te konsultohen me specialistet perkatese. Mbjellja e bimesise ne hapsirat boshe, krijon hije dhe kushte klimatike te pershtatshme per kalimtare apo frekuentuesit pergjate rrugeve dhe zonave ku do te kaloje gjurma e projektit.

Mundesia e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe kthimi i mjedisit ne gjendjen e meparshme. Pas perfundimit te punimeve ndertimore, do te behet pastrimi dhe largimi i mbetjeve inerte qe mund te kene ngelur, gjelberimi qe eshte pjese e projektit, por nuk mund te pretendojme

rikthim ne gjendjen e mepareshme te vendit ku do te kryhen punimet per ndertimin aksive rrugor Njesite Administrative 4+8+12, (ALi Pash Gucia, Degezimet tek Rruga “Ramamzan Gaxherri”, Rruge “Rexhep Tarja” dhe degezimi i saj Rruga “Kleanthi Koci”).

ë) Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative

Ne menyre te pergjithshme do te japim disa prej masave qe duhet te zbatohen nga investitori ose nenkontratuesit per zbatimin e projektit. Disa prej masave kryesore qe do te ndermerren jane permendur ne menyre te permbledhur si me poshte:

Masat lehtesuese qe do te ndermerren gjate ndertimit dhe funksionimit te projektit ndertimi dhe rikonstruksioni i plote i rrugve ne Njesite Administrative 4+8+12, (ALi Pash Gucia, Degezimet tek Rruga “Ramamzan Gaxherri”, Rruge “Rexhep Tarja” dhe degezimi i saj Rruga “Kleanthi Koci”), Vleresimi i ndikimit ne mjedis duhet te ndikojë ne dhenien e zgjidhjeve per shmangie te ndotjes dhe mbrojtjes se mjedisit. Mbrojtja e mjedisit perben ne vetvete nje sere masash zbutese, parandaluese. Ne menyre te pergjitheshme do te japim disa prej masave qe do te ndermerren nga investitori per ndertimin e projektit ndertimi dhe rikonstruksioni i plote i rrjetit rrugor Njesite Administrative 4+8+12, (ALi Pash Gucia, Degezimet tek Rruga “Ramamzan Gaxherri”, Rruge “Rexhep Tarja” dhe degezimi i saj Rruga “Kleanthi Koci”). Në fazën fillestare të punimeve, do të kryhet punë përgatitore për pastrimin e vendit dhe përgatitje për fillimin e punimeve sic jane rilevimet e vendit etj.

Kerkesat mjedisore qe synojne mbrojtjen e shendetit e te mjedisit, perfshijne specifikimin e kushteve, normave e standarteve te detyrueshme per mbrojtjen e pastertise se ajerit urban, te ujerave siperfaqesore e nentokesore, te cilesise e vlerave te tokes, te territoreve urbane, rrugeve, tortuareve, zonave te gjelberuara.

Ne menyre te pergjithshme do te japim disa prej masave qe duhet te zbatohen nga investitori ose nenkontratuesit per zbatimin e projektit. Disa prej masave kryesore qe do te ndermerren jane permendur ne menyre te permbledhur si me poshte:

Masat lehtesuese qe do te ndermerren gjate ndertimit dhe funksionimit te projektit per ndertimin e bllokut te rrugeve.

Vleresimi i ndikimit ne mjedis duhet te ndikojë ne dhenien e zgjidhjeve per shmangie te ndotjes dhe mbrojtjes se mjedisit. Mbrojtja e mjedisit perben ne vetvete nje sere masash zbutese, parandaluese. Ne menyre te pergjitheshme do te japim disa prej masave qe do te ndermerren nga investitori per ndertimin dhe rikonstruksionin e ketij aksi rrugor. Në fazën fillestare të punimeve, do të

kryhet punë përgatitore për pastrimin e vendit dhe përgatitje për fillimin e punimeve sic janë rievimet e vendit etj.

Kerkesat mjedisore që synojnë mbrojtjen e shëndetit e të mjedisit, përfshijnë specifikimin e kushteve, normave e standarteve të detyrueshme për mbrojtjen e pastërtisë së ajrit urban, të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore, të cilësive e vlerave të tokës, të territoreve urbane, rrugëve, tortuareve, zonave të gjelbëruara.

Masat mbrojtëse dhe parandaluese që rekomandohen gjatë fazës së ndërtimit

- Të bëhet rrethimi i zonës së ndërtimit në të gjithë perimetrin e saj për të shmangur daljen e gjithfarë mbeturinash inerte, për të bërë një plan organizimi sa më të mirë të objektit dhe për të shmangur gjithashtu impaktin negativ që krijojnë punimet.
- Largimi i dherave/inerteve që do të dalin nga projekti, do të kryhet brenda një kohe shumë të shkurtrë nga krijimi i tyre duke mos krijuar ndotje në ambientin përreth. Largimi i tyre do të bëhet natën duke marrë masa për të mos ndotur rruget. Kjo realizohet duke mbuluar me mushama mbeturinat që transportohen dhe duke i lare gomat e makinave para se të dalin nga sheshi i ndërtimit. Mbetjet urbane do të grumbullohen në përfundim të objektit në vende të caktuara nga Njësia e Qeverisjes Vendore (Bashkia e Tiranës).
- Vendosja e rrjetave mbrojtëse për minimizimin e pluhurave dhe mbrojtjen e kalimtareve.
- Realizimi i infrastrukurës rrugore do të realizohet në përputhje me studimin urbanistik të zonës përkatëse duke i lënë vend edhe sipërfaqes së gjelbër sipas projektit.
- Mbeturinat në përfundim të ndërtimit rrugëve do të grumbullohen, transportohen dhe depozitohen në vendet dhe oraret e caktuara nga Njësia e Qeverisjes Vendore (Bashkia e Tiranës).
- Nderhyrjet në rrjetin e infrastrukurës do të kryhen me lejet e institucioneve përkatëse sipas ligjeve në fuqi.
- Ndërtimi do të kryhet nën kontrollin e inspekteve të mjedisit, për të matur ndotjet në mjedis të cilat nuk do të kalojnë parametrat e lejuar.

Masat kryesore per mbrojtjen e cilesise se ajerit.

Me qellim qe shkarkimet ne ajer qe emeton veprimtaria ndertuese te jene vazhdimisht brenda normave te lejuara, subjektet ndertuese marrin keto masa:

- Te perdoren mbulesa te perkohshme dhe te lagen sipas nevojës sheshet e punimeve, nje deri ne dy here ne dite per te reduktuar clirimet e pluhurave sidomos ne kohe te thate;
- Per levizjen e materialve te perdoren konvehere te mbyllur;
- Te behet mirmbajtja e sheshit gjate kryerjes se punimeve;
- Te gjitha materialet e transportuara jashte sheshit te ndertimit te jene te lagura ne menyre te mjaftueshme ose te mbuluara mire;
- Te gjitha aktivitetet e pastrimit, nivelimit, ndertimit te rruges Lezha 1, transportit te nderpriten gjate periudhave me ere te forte;
- Te kufizohet shpejtesia e levizjes se automjeteve deri ne 30 km/ore;
- Te ndalohet pergatitja dhe perpunimi i bitumeve ne temperatura te larta ne vendin ku do te ushtrohet aktiviteti, dhe te perdoren bitume qe kane shkalle te vogel clirimesh te ndotesve ne ajer;

Masat kryesore per ruajtjen e flores/faunes.

Ndikimet negative të shkaktuara në biodiversitet nga pluhurat dhe zhurmat kanë vetëm rrugë reduktimi siç është përcaktuar në uljen e niveleve të tyre për ajrin dhe ujin. Përsa i përket humbjes së biomasës në territorin që do të shfrytëzohet, habitateve të fragmentizuara nuk do të kete pasi sic e kemi permendur edhe me siper projekti do të zhvillohet ne gjurmen ekzistuese te rruges, dhe nuk do te ndikojë ne biomase. Në këtë mënyrë mund të sigurohet një vazhdimësi natyrore e vegetacionit në zonat përreth.

Masat kryesore per zvogëlimin e zhurmave do të përfshijnë:

- Te respektohen standartet per nivelet e zhurmave ne zonat urbane dhe urbane dhe rurale sipas rastit.
- Mirëmbajtje dhe funksionimin e duhur të makinerive të ndërtimit për të minimizuar burimin e zhurmës.

Masat kryesore per trajtimin e ujerave:

Ujerat qe dalin nga aktiviteti i ndertimit te rrugeve ne Njesite Administrative 4+8+12, (ALi Pash Guçia, Degezimet tek Rruga “Ramamzan Gaxherri”, Rruge “Rexhep Tarja” dhe degezimi i saj Rruga “Kleanthi Koci”, te zones jane ujera

te cilat lindin si rrjedhoje e aktivitetit te lagies se vendit ku do te kaloj projekti, larjes se gomave te automjeteve, funksionimit te projektit dhe ujerat e reshjeve nga kushtet atmosferike. Gjate ndertimit, ne varesi edhe te rreshjeve te shiut, mund te grumbullohet sasi e konsiderueshme e ujerave dhe si rrjedhoje mund te jete i nevojshem grumbullimi i ketyre ujerave dhe orientimi i tyre ne sistemin e kanalizimeve, dhe pse pjeserisht ato filtrojne nentoke dhe ne kunetat e ndertuara me pare ne kete aks rrugor per grumbullimin e ujerave te shiut.

Ujerat qe dalin nga aktiviteti i ndertimit te rrugeve ne Njesite Administrative 4+8+12, (ALi Pash Gucia, Degezimet tek Rruga "Ramamzan Gaxherri", Rruge "rexhep tarja" dhe degezimi i saj Rruga "Kleanthi Koci", te zones jane ujera te cilat lindin si rrjedhoje e aktivitetit te lagies se vendit ku do te kaloj projekti, larjes se gomave te automjeteve, funksionimit te projektit dhe ujerat e reshjeve nga kushtet atmosferike. Gjate ndertimit, ne varesi edhe te rreshjeve te shiut, mund te grumbullohet sasi e konsiderueshme e ujerave dhe si rrjedhoje mund te jete i nevojshem grumbullimi i ketyre ujerave dhe orientimi i tyre ne sistemin e kanalizimeve, dhe pse pjeserisht ato filtrojne nentoke dhe ne kunetat e ndertuara me pare ne kete aks rrugor per grumbullimin e ujerave te shiut.

Dëmtim i Peisazhit

Gjatë zbatimit duhet të tregohet kujdesi i duhur për të ruajtur peisazhin natyror në mënyrë që të parandalohet çfarëdo shkatërrim i panevojshem, ndryshime në relief etj.

Eshte i domosdoshëm

- Pastrimi i territoreve nga mbetjet gjatë ndërtimit.
- Mbrojtja e mbulesës bimore,
- Ruajtja e karakteristikave te dherave dhe relievit etj.

Nga zbatimi i këtij projekti, nuk parashikohen te priten pemë.

Me përfundimin e punimeve, të gjitha pajisjet dhe materialet e tepërta do të hiqen, dhe do te depozitohen ne territore të caktuara per këtë qellim nga autoritetet vendore. Çdo mbjellje ne territor, do te kryhet me bimë autoktone, me përjashtim te atyre me efekte aromatike, dhe dekorative.

Duhet të zvogelohen impaktet negative që vijne si rezultat i ndertimit në nivelin me të ulët të mundshëm dhe që sigurojnë makineritë që operojne brenda zonës së ndërtimit.

Zonat e depozitimit do të pozicionohen ne menyre që te menjanohen impaktet e metejshme ne pronat private e banesat ekzistuese, pemet, gardhimet, etj. dhe si te tilla do të kenë prioritet për tu ndertuar apo do të lihen ne fund të kontrates së ndërtimit.

Materialet e gërmuara që janë te menduara per rishfrytezim do te menaxhohen dhe transferohen deri ne minimum dhe do te depozitohen në zona të caktuara nga pushteti lokal.

Reduktimi në Biodiversitetit

Ashtu sic u thksua tek permbledhja e ndikimeve, zona ne te cilen do të kryhet ndërtimi sdo të ketë impakt ne faunën e zonës. Gjithsesi, për të minimizuar dëmet ndaj kafshëve, eshte i nevojshem nje bashkerendim veprimesh.

- Të minimizohet dëmtimin dhe reduktimin e habitateve nga aktivitetet ndërtimore;
- Minimizohet shkatërrimi i foleve dhe strofkullave;
- Parandalojë, gjuetinë dhe mbledhjen e vezëve nga punëtorët e ndërtimit;
- Ndalojë mbledhjen e druve të zjarrit nga zonat e punës
- Minimizojë dëmet ndaj rrjedhave ujore nga punimet tokësore dhe nga hedhja e mbeturinave të papershtatshme.

Këto do të arrihet nëpërmjet:

- Përdorimi i vendeve te përcaktuara dhe të miratuara per hedhjen mbeturinave të lëngshme dhe solide
- Edukimi i ekipeve ndërtimore mbi ndikimin e shqetësimit dhe dëmtimit të habitateve dhe masave parandaluese te tyre;
- Ndalimi i rreptesishem i ndezjes se zjarrit;
- Te sigurohen qe kushtet e punësimit te parashikojne dënime të rënda për prishje të panevojshme të habitateve të rëndësishme.
- Para çdo aktivitet ndërtimi duhet të kryhet sigurimi me gardh i zonave te ndjeshme.

Toka dhe Ndotja e Ujit

Gjatë punimeve duhet të kryhen të gjitha aktivitetet në një mënyrë që të parandaloje ndotjen e tokës nga derdhjet aksidentale të lëndës së ngurtë dhe lënget, ndotesve, mbeturinat, dhe ndotësve të tjerë të papershtatshem.

Nëse një derdhje serioze ndodh:

- Duhet të hiqen apo pastrohet tërë toka e kontaminuar
- Dherat e larguara duhet te zevendesohen nga material te ngjashme.

Aktivitetet do të kryhet në një mënyrë që do të parandalojë hyrjen ose derdhjen aksidentale të lëndës së ngurtë, ndotesve, mbeturinat, dhe ndotësve të tjerë të pakëndshëm.

Erozioni, trazimi dhe ngarkesa e sedimenteve

Gjatë ndërtimit duhet te kryhet një procedurë spastrimi te vendit që ndan shtresen e punueshme dhe ruan atë nën kushte të përshtatshme për ripërdorim

Për këtë arsye duhet që:

- Që ndërmerren të gjitha masat duke përfshirë te gjitha teknikat mbrojtese për të ruajtur zonat e spastruara nga precipitimi i materialit te ndotur.
- Puna gerryese duhet të kryhet në një mënyrë që do të parandaloje ujin e ndotur te derdhet ne themele, kanale etj dhe prej atje te derdhet ne lumë.
- Sasite e tepërta të materialeve të padëshiruara dhe agregate te magazinuara ne vend duhet të shmangen.

- Kur magazinimi është i nevojshem, duhet të sigurohet që pirgjet dhe rezervat janë të vendosura në vende ku nuk lejojnë derdhje drejtpërdrejtë dhe janë në pjerrësi të tokës në më pak se 1.5%.
- Të gjitha grumbujt dhe pirgjet do të jenë të një madhësie dhe stabiliteti që do të sigurojnë evitimin e rrezikut të lëvizjes masive gjatë periudhave të reshjeve me intensitet të lartë
- territorin e objektit.

Zhurma dhe pluhuri

Zhurma nga aktivitetet e ndërtimit kryesisht do të rrjedhin nga operimi i objektit dhe pajisjeve. Per kete arsye:

- Duhet të sigurohet që të gjitha pajisjet e tij të jenë të përshtatshme për mbytjen e zhurmës që do të reduktojnë emetimet e zhurmes
- Të gjitha pajisjet e tjera do të pajisen me aparate të përshtatshme kundër zhurmes në përputhje me rekomandimet e prodhuesit.
- Automjetet që janë tepër të zhurmshme për shkak të punës difektoze të motorrit nuk do të perdoren për ndërtim.
- Duhet të shmangët shkaktimi i zhurmave, dridhjeve apo pluhurave në territoret e punës.
- Në rast se ndikime të tilla, do të jenë në nivelin e mbi normave të legjislacionit ekzistues, duhet të pezullohen punimet deri në përmirësimin e situatës dhe evitimin e ndotjeve të ajrit të lartpërmendura.

Aktiviteti më i zhurmshëm aktual, nuk pritet të jetë i nevojshëm për këtë projekt. Masat specifike për evitimin e pluhurit do të përfshijnë:

- Lagjen e kantierit dhe rrugëve hyrëse;
- Përdorimin e rrethimeve mbrojtëse/izoluese të përshtatshme;
- Mbulimi i të gjitha automjeteve që transportojnë materiale që nxjerrin pluhur të tepruar; dhe,
- Mos lejimin e kamionëve të mbingarkuar.

Asnjë impiant i përdorur në vend nuk do të lejohet të shkaktojë një bezdi publik si pasojë e zhurmës. Në këtë mënyrë duhet:

- Zbatueshmëri duke përfshirë mirëmbajtjen e duhur të projektit dhe angazhimin për të ulur zhurmën e krijuar nga veprimet në vend.
- Të gjitha makinat dhe impiantet mekanike do të përshtaten me silenciator efektiv dhe të mbajtur në funksion të mirë gjatë kohës së kontratës,
- Kompresoret do të jenë modele lehtësuese të përshtatura me kapake akustike të duhur me viza dhe të mbyllur të cilët do të mbahen të mbyllur kurdo që makina punon dhe të gjitha mjetet vartëse pneumatike do të përshtaten me silenciatorë.
- Makineria që është përdorur pa ndërprerje do të fiket ose t'i ulet shpejtësia në minimum (ose t'i mbyllet valvula) gjatë periudhës kur nuk perdoret.

- Cdo impiant si psh gjenerator ose pompe, që kërkohet të veprojë para dhe pas orëve të ligjshme të punës, do të rrethohet nga një mbyllje akustike ose nga ndonjë mbyllës portativ.

Masat specifike per evitim e zjarrit dhe reagimin ndaj tij apo aksidenteve do të perfshijnë:

- Rrespektimin e rregullores kunder zjarrit dhe vendosjen e pajisjeve për mbrojtjen ndaj zjarrit në kampet e punës
- Organizimin e territoreve të punes në menyrë të atillë që të parandalojnë zjarret apo aksidentet e tjera.
- Mbajtjen në gadishmeri të mjeteve me ujë dhe pompave përkatëse të emergjences, grumuj te rëres per kontrollin e zjarrit etj.
- Ngritjen e nje sistemi te reagimit emergjent, me nje rrjet te mirecaktuar veprimesh dhe komunikimesh,
- Ekspozimin ne vende të dukshme te numrave te zjarrfikses, policise, ambulances etj.
- Perfshirjen ne sistemin e planit të menaxhimit të trafikut, edhe të akseseve të emergjencës në raste zjarresh e aksidentesh
- Pajisjen e territorve te punes dhe objektit me kutitë e nderhyrjes se shpejtë, me shenjat përkatëse dhe lehtesisht të dukshme.

Shkatërrimi i mbetjeve

Shkatërrimi i të gjitha materialeve të ndërtimit të tepërta dhe mbeturinave do të kryhet në përputhje me rregullat e Menaxhimit të Mbeturinave të Ngurta. Per këtë arsye:

- Mënyra normale e shkatërrimit do të përfshijë të gjitha masat e nevojshme për të minimizuar ndotjen e ujit dhe te ajrit, bllokime te kullimit, rreziku nga zjarri dhe dëmtimet e ekosistemeve.
- Vetem zona hedhjesh te miratuara / groposje do të përdoren për hedhjen e mbeturinave të tepërta.
- Dherat e tepert do të hidhen menjëherë në mënyrë që të minimizojnë kohën e magazinimit në vendin e ndërtimit dhe rrezikun e erozionit dhe shkarkimin e sedimenteve.
- Këto materiale do të kërkohen më vonë në Programin e punës që ata do të ruhen në mënyrë të duhur.
- Materialet e dheut nuk do të hidhen në gropa nëse ripërdoren si mbulesë e përditshme apo përfundimtare.

Materialet e gërmuara që janë të menduara për rishfrytezim do te menaxhohen dhe transferohen deri ne minimum.

Me përfundimin e objektit të ndërmerret masa me ndihmën e inspektimeve. Kjo mund të ulë impaktin e mundshem ne të ardhmen për humbjen e dherave apo impaktet që lidhen me terrenin.

Siguria publike dhe siguria e punëtorëve

Territori dhe zonat për riparim do të jenë të mirë reklamuar me shenjat perkatese për ruajtjen nga aksesimi i paautorizuar dhe shenjat paralajmëruese të përshtatshme të ngritura.

Të gjitha zonat e Projektit do të percaktohen si zona për “kokore”.

Përveçse zbatimin të Rregullores dhe Sigurisë Teknike”, të gjithë punonjësit duhet të pajisen me uniformat e punës, të njihen me planin e reagimit në rast aksidentesh, etj.

Procesi i monitorimit përfshihet në një program të ngritur mbi planin e monitorimit gjatë ndërtimit dhe atë gjatë operimit.

Monitorimi gjatë ndërtimit

Monitorimi nga menaxheri i ndërtimit do të jetë kryesisht në vendet e ndërtimit dhe të kampit nga kontraktori dhe Inspektoriati Mjedisor. Monitorimi i vendeve të tjera do të ndërmerren nga Kontraktori me vizita të kohëpaskohshme nga specialistet e dhe Bashkisë Tiranë dhe Njësitet administrative. Për një projekt si ky, këto çështje do të trajtohen si nga ana cilësore edhe ajo sasiore, përveç zhurmës nga pajisjet e ndërtimit dhe emisionet nga gjeneratorët, për të cilën Kontraktori do të sigurojë pajisjet e duhura të monitorimit.

Për matjet e zhurmës, si pike referimi do të merren matjet ekzistuese, që do të konsiderohen si pika referimi të gjendjes mjedisore. Lexime fillestare do të merren në vende të ndryshme brenda zonës së projektit dhe procesi fillon para fillimit të ndërtimit në mënyrë efektive dhe do të përbëjë monitorimin bazë.

f) Ndikimet e mundshme në mjedisin nderkufitar (nese projekti ka natyre të tille).

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhojë edhe ndikimi i tij nuk shkakton dëmim të mjedisit nderkufitar.

Projekti nuk ndikon në cenimin e sigurisë së jetës dhe shëndetit as të shteteve fqinje, as të qendrave të banuara të rajonit.

Nuk ndikohen burimet ujore nderkufitare, nuk ndikohet cilësia e ajrit në kontekstin nderkufitar.

Për këtë kapitull, nuk kryhen vlerësime dhe analiza të detajuara për shkak të vendodhjes së projektit në brendësi të kufirit shtetëror dhe distancës që ai ruan me kufirin dhe shtetet fqinje.

Projektues: B.O.E “Infratech & Engineering Consulting Group” sh.p.k

Perfaqësues me prokurë : O.E “Infratech” sh.p.k

Administrator : Ing. Filjana Veizaj